68	**KULLA E VRETOS**	DHERMI		HIMARE	VLORE	I	Minis. e Arsimit dhe e Kulturës	266/1	16.02.1979

69	**KULLA E KUMIVE** ne fshatin Dhermi	DHERMI		HIMARË	VLORË	I	Minis. e Arsimit dhe e Kulturës	266/1	16.02.1979
70	**KASOLLET E EQEREM HADERIT** ne fshatin Amonice	AMONICË	SEVASTËR		VLORË	I	Minis. e Arsimit dhe e Kulturës	266/1	16.02.1979
71	**TAVANI DEKORATIV NE SHTEPI TE PIRRO GJIKOPULLIT**	DHERMI		HIMARË	VLORË	I	Minis. e Arsimit dhe e Kulturës	266/1	16.02.1979
72	**ANSAMBLI I RRUGES"JUSTIN GODAR"**			VLORË	VLORË	I	KESHILLI I MINISTRAVE	249	01.07.1980
73	**GODINA KU KA PASUR SELINE QEVERIA PROVIZORE E ISMAIL QEMALIT NE SKELEN** e Vlores			VLORË	VLORË	I	Rektorati Universitetit Shtetror	6	15.01.1963
74	**SHTËPIA KU U FORMUA KOM.QARKOR I PARTISË PËR QARKUN E VLORES.L.'Partizani'**, Rruga "Drashovice", nr.34, Vlore			VLORË	VLORË	I	Ministria e Arsimit dhe e Kulturës	Urdhëres	08.01.1977
75	**KULLA E DERVISH ALIUT** ne fshatin Dukat, Vlore	DUKAT		ORIKUM	VLORË	I	Minis. e Arsimit dhe e Kulturës	266/1	16.02.1979
76	**"KLUBI LABËRIA".**			VLORË	VLORË	I	Minis. e Arsimit dhe e Kulturës	1938/1	14.05.1982
77	**RRUGA E HEBREJVE**, Vlore				VLORË	I	M.T.K.R.S.(Drej.Trash.Kulturës)	525	14.09.2006
78	**ISH PREFEKTURA**				VLORË	I	M.T.K.R.S.	654	09.11.2006
79	**BANESA Rr. "Ismet Çakërri"**				VLORË	I	M.T.K.R.S.	654	09.11.2006
80	**SHKOLLA E PARË NR. 1 Rr. "Ismet Çakërri"**				VLORË	I	M.T.K.R.S.	654	09.11.2006
81	**SHTËPIA E RRADHIMAJVE Rr." Ismet Çakërri"**				VLORË	I	M.T.K.R.S.	654	09.11.2006
82	**BANKA TREGTARE**				VLORË	I	M.T.K.R.S.	654	09.11.2006
83	**MUZEU HISTORIK**				VLORË	I	M.T.K.R.S.	654	09.11.2006
84	**BANESA PRANË KLUBIT LABËRIA**				VLORË	I	M.T.K.R.S.	654	09.11.2006
85	**GODINË VITI 1925 Rr. "Zogu I I "**				VLORË	I	M.T.K.R.S.	654	09.11.2006
86	**ISH GALERIA E ARTEVE** , RR. "Zogu i I".				VLORË	I	M.T.K.R.S.	654	09.11.2006
87	**GODINË DY KAT Rr. "Zogu I I "**				VLORË	I	M.T.K.R.S.	654	09.11.2006
88	**GODINË DY KAT Rr. " Zogu i I "**				VLORË	I	M.T.K.R.S.	654	09.11.2006
89	**BASHKIA**				VLORË	I	M.T.K.R.S.	654	09.11.2006
90	**ISH HETUESIA Rr. "ISA BULETINI"**				VLORË	I	M.T.K.R.S.	654	09.11.2006
91	**SHTËPIA E FORMIMIT TË QEVERISË 1920**				VLORË	I	M.T.K.R.S.	654	09.11.2006
92	**SAHATI KOMPLEKS Rr."8 Marsi"**				VLORË	I	M.T.K.R.S.	654	09.11.2006
93	**KOMPLEKSI TEK MUZEU Rr."8Marsi"**				VLORE	I	M.T.K.R.S.	654	09.11.2006
94	**KOMPLEKSI MBI MUZEUN**				VLORË	I	M.T.K.R.S.	654	09.11.2006
95	**BANESA DY KAT Rr, "Gjergj Kastrioti"**				VLORE	I	M.T.K.R.S.	654	09.11.2006
96	**BANESË Rr. "Gjergj Kastrioti"**				VLORE	I	M.T.K.R.S.	654	09.11.2006
97	**BANESA E ÇIFUTIT Rr."Lef Sallata"**				VLORE	I	M.T.K.R.S.	654	09.11.2006
98	**BANESA E EQEREM BEJ VLORËS**				VLORE	I	M.T.K.R.S.	654	09.11.2006
99	**KISHA KATOLIKE Rr."Kristo Negovani"**				VLORE	I	M.T.K.R.S.	654	09.11.2006
100	**BANESA E FAMILJES HOXHA PËRBALLË KISHËS**				VLORE	I	M.T.K.R.S.	654	09.11.2006
101	**BANESA E ZIGUR LELOS** ne fshatin Mesaplik, Komuna Brataj, Vlore	MESAPLIK	BRATAJ		VLORE	I	M.T.K.R.S.	202	28.03.2007
102	**BANESË DY KATËSHE 110 vjeçare NE GJENDJE RRËNOJE (Prone e familjes Deromemaj)**	MESAPLIK			VLORE	II	M.T.K.R.S.(Drej.Trash.Kulturës)	521	14.09.2006
103	**SHTËPIA E HALIM XHELOS** ne Vlore **KU U THEMELUA KOMITETI QARKOR I RINISË**				VLORE	I	Ministria e Arsimit dhe e Kulturës	1886	10.06.1973
104	**SHTËPIA E FETI ELMAZIT KU KA QENDRUAR KËSHILLI NACIONAL ÇLIRIMTAR I QARKUT TË VLORËS**	RAMIC			VLORE	I	Ministria e Arsimit dhe e Kulturës	1886	10.06.1973
105	**SHTËPIA MUZE E VËLLEZERVE NUSHI** ne fshatin Vuno	VUNO			VLORE	I	Ministria e Arsimit dhe e Kulturës	1886	10.06.1973
106	**BANESA E ISLAM GJONIT**, Vlore.- **KU NËN DREJTIMIN E ENVER HOXHËS ËSHTË BËRË MBLEDHJA KU U SHPARTALLUAN ELEMENTET FRAKSIONISTE**				VLORE	I	Ministria e Arsimit dhe e Kulturës (Drejtoria e Kulturës)	377	22.01.1985
107	**BANESA E MURAT XhELILIT** ne Dushkarak, Vlore **Ku eshte formuar Nac-Çlir.i Qarkut ne 5 shtator 1943**	DUSHARAK			VLORE	I	Ministria e Arsimit dhe e Kulturës (Drejtoria e Kulturës)	377	22.01.1985
108	MUZEU(**BANESA KU KA LINDUR HYSNI KAPO**)- ne fshatin Terbac te Vlores	TERBAÇ	HORE-VRANISHT		VLORE	I	Minis. e Arsimit dhe e Kulturës	266/1	16.02.1979
109	**BANESA E SHKRIMTARIT PETRO MARKO**				VLORE	I	M.T.K.R.S. (MINISTRI)	807	29.07.2008
110	**ZONA ARKEOLOGJIKE 'A" DHE "B" TE QYTETIT DHE RREGULLORJA ADMINISTRIMIT**				VLORE		KËSHILLI I MINISTRAVE	729	01.09.2010

Burimi i informacionit: Ministria e Kultures, (Faqja Zyrtare).

3. INFORMACION PËR PRANINË E BURIMEVE UJORE NË SIPËRFAQEN E KËRKUAR NGA PROJEKTI DHE NË AFËRSI TË SAJ.

Ne zonen e zbatimit te ketij projekti ka burime ujore te rendesishme te identifikuara. Burimi ujor me i rendesishem i kesaj zone eshte pikerisht Deti Jon, brenda se cilit zhvillohet edhe aktiviteti i rritjes intensive te peshkut.

Deti Jon dhe brigjet e tij shqiptare

Ky det shtrihet midis pjeses jugore te gadishullit te Ballkanit dhe gadishullit Apenin. Ai eshte deti me i thelle i Mesdheut (5121 m), eshte det i hapur dhe mjaft i ngrohte.

Brigjet shqiptare te ketij deti shtrihen nga gadishulli i Karaburunit deri ne gjirin e Artes. Ai eshte i gjate rreth 270 km dhe ka tipare te ndryshme. Pergjate tij ngrihen male, prandaj ky bregdet eshte kryesisht i larte e shkermbor. Ne kete bregdet plazhet jane te rralla dhe zallishte. Ka edhe sektore te tjere te tij ne te cilet malet u lene vend fushave te vogla. Ne grykederdhjen e lumit te Kalamasit (Cameri) dhe te lumit te Pavlos (Shqiperi) brigjet jane te uleta e fushore, me plazhe ranore dhe sektore te mocalizuar.

Pamja terheqese, burimet e pastra, shkelqimi i diellit, ujerat e kaltra dhe te tejdukshme to detit u japin ketyre plazheve vlera te medha turistike.

Deti Jon (greqisht Ιόνιο Πέλαγος, italisht Mar Ionio), është një pjesë e Detit Mesdhe në jug të Kanalit të Otrantos dhe Detit Adriatik. Në lindje kufizohet nga Shqipëria jugore dhe Greqia perendimore me një sërë ishujsh si Korfuzi, Zákynthos, Qefallonia, Itaka dhe Leukas, kurse në perëndim kufizohet nga brigjet e Siçilisë dhe Italisë jugore. Midis Apulies dhe Kalabrisë gjendet Gjiri i Tarentit.

Deti Jon, është njëri prej dy deteve që lag brigjet e Shqipërisë. Bregdeti është i lartë, shkëmbor me bukuri të shumta natyrore. Deti Jon është nga vozitësit e anijeve shumë i njohur për erërat e tij të qeta. Ai është deri në 4206 metra i thellë. Në detin Jon derdhen Lumi Kalama dhe Lumi i Artës që janë paksa më të njohur, si dhe lumenjtë Pavlla, Kalasa, Bistrica etj.

4. IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NEGATIVE NË MJEDIS.

Pershkrimi i aktivitetit

Aktiviteti ne vleresim eshte instalimi i disa koshave lundrues me qellim rritjen intensive te peshkut(llojet Koce dhe Levrek). Projekti zhvillohet ne vijen bregdetare te Detit Jon, rreth 90m larg vijes bregdetare ne vendin e quajtur "Gjiri Rraguza 2, Karaburun", ne territorin administrativ te Bashkise Orikum, Prefektura Vlore.

Te dhenat teknike te objektit paraqiten si me poshte:

Siperfaqja$_{ujore}$**=5ha (0.05km^2).**
Kapaciteti$_{prodhues}$ **=50 kosha lundrues.**
Distanca nga bregu: **L=40m (Pika me e afert e kufirit)**
Faktike eshte L=90m nga bregu vaskat
Thellesia e ujit: **h=40-42m.**
Emertimi i zones : **Gjiri Rraguza 2**

Vendodhja

Gjiri Rraguza 2, Karaburun, Bashkia Orikum, Qarku Vlore.

Pamje te objektit ekzistues

Vaskat e rritjes se peshkut jane vendosur rreth 90m larg bregut te detit, aty ku dhe thellesia e ujit arrin mbi 40m(sipas deklarimit te administratorit), ndersa stacioni tokesor eshte ne bregun e gjirit. Vaskat kane forme rrethore me rrjeta sintetike te pajisura me ure kalimi me parapet sherbimi, duke qene se instalimi eshte kryer ne det te hapur.

Procesi i prodhimit

a)Rasati qe popullone Instalimin

Duke konsideruar kushtet qe ofron vendi, me qellim ofrimin e nje cilesie te larte ne treg, rasati sigurohet nepermjet importimit nga Greqia, ne nje nga shoqerite elitare ne akuakulturen intensive me kosha notues.

b)Ushqimi

Ushqimi i rasatit Koc-Levrek eshte eshte nje nga prioritet e Shoqerise. Ushqimi ka nje rendesi te vecante jo vetem ne nxjerrjen e nje produkti cilesor ne treg por edhe ne shendetin e rasatit, e per rrjedhoje edhe per te gjithe ciklin e prodhimit. Furnizuesi me ushqim sigurohet nepermjet importimit nga Greqia, pasi vleresojme se arrihet raporti me i larte i mundeshem i faktoreve cmim-cilesi. Perberesit kryesore te ketij ushqimi qe perdoret ne impiant, jane te nje cilesie te larte e cila kontrollohet periodikisht per te garantuar ne produkt "BIO".

c)Amballazhi dhe Transporti

Peshku nxirret ne treg me nje peshe 320 – 350 gr/cope. Per amballazhimin dhe nxjerrjen e tij ne treg perdoren arka plastike njeperdorimshe te ricikluesshme, nderkohe qe transporti kryhet nepermjet mjeteve frigoriferike qe disponon kompania.

Procesi teknologjik

Kultivimi dhe rritja e llojit te peshkut koce - levrek kerkon uje te paster, rryma uji te mbrojtura nga ererat dhe detet e fuqishme.Gjithashtu instalimi i koshave behet prane objektit te domosdoshem per zhvillimin e aktivitetit.

Procesi Teknologjik i kultivimit dhe rritjes se peshkut koce-levrek me kosha notues:

- Koshat lundruese nderohen me skelet metalik -plastik te lidhshme njera nga tjetra me skelet me materiale druri te fiksuara ne fuci plastike per te siguruar lundrimin;
- Thellesia e ujit ne det eshte mbi 40m;
- Dimensionet e koshave zakonisht jane ø12x10m, ø19x10m te thella;
- Koshi formohet nga rrjeta nejloni me syze nga 10mm deri 16mm ne varesi te madhesise te peshkut;
- Per te siguruar stabilitet per koshin ne kater cepat e tij vendosen litare te fiksuar me spirance ose me blloqe betoni;
- Distanca nga toka eshte me e madhe se 90m;
- Cikli i rritjes eshte 12-16 muaj;
- Firot e rritjes gjate gjithe periudhes jane 8 -10% e totalit;
- Peshku tregtohet ne peshen 320-350 gr/cope me seleksionim;
- Per te rritur 1 kg peshk duhen 1.6 kg ushqimi i koncetruar;
- Rasati importohet nga Greqia me dimesionet 2-4 gr / cope me certificate veterinare konforme ligjeve te BE. Gjithashtu edhe ushqimi i peshkut importohet nga Greqia nga firma te miratuara nga BE shoqeruar me flete analiza e raport veterinar. Ushqimi ruhet ne vende te thata dhe pa drite;
- Cdo muaj behen matjet e peshkut (pesha, gjatesia) dhe mbi bazen e treguesve ndertohet receptura e ushqimit, kjo e kushtezuar nga temperatura e ujit e cila matet cdo dite;
- Cdo 3 mujor behen analizat e ujit per treguesit e cilesise se ujit, hidrokimike duke i krahasuar ato me tabelat e literatures;
- Ne biznesin tone mbahet ditari i vrojtimeve duke pershkruar te gjithe tregesit hidro-biologjike dhe natyrore;

Lloji i ndikimeve të identifikuara (direkte dhe jo direkte)
Vleresimi i ndikimeve ne mjedis kryhet duke u bazuar mbi parimet e mbrojtjes se mjedisit te cilat jane:

- Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm
- Parimi i parandalimit dhe marrja e masave paraprake
- Parimi i ruajtjes së burimeve natyrore
- Parimi i zëvendësimit dhe/ose kompensimit
- Parimi i qasjes së integruar
- Parimi i përgjegjësisë së ndërsjellë dhe bashkëpunimit
- Parimi "Ndotësi paguan"
- Parimi i së drejtës për informim dhe i pjesëmarrjes së publikut
- Parimi i nxitjes së veprimtarive për mbrojtjen e mjedisit

Ky vleresim kryhet ne baze te ligjit Nr. 10440, date 07.07.2011 "Per vleresimin e Ndikimit ne Mjedis" dhe VKM Nr. 686, date 29.07.2015 Per zhvillimin e procedures se VNM-se dhe ka si synim idnetifikimin, vleresimin dhe parandalimin e ndotjes se mjedisit, me qellim mbrojtjen e mjedisit. Me mbrojtje te mjedisit do te kuptojme mbrojtjen e mjedisit nga ndotja e dëmtimi. Kjo përbën përparësi kombëtare dhe është e detyrueshme për çdo banor të Republikës së Shqipërisë, për të gjitha organet shtetërore, si dhe për personat fizikë dhe juridikë, vendas e të huaj, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Objektivat e mbrojtjes së mjedisit janë:

a) Parandalimi, kontrolli dhe ulja e ndotjes së ujit, ajrit, tokës dhe ndotjeve të tjera të çdo lloji;
b) Ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i natyrës dhe i biodiversitetit;
c) Ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i qëndrueshmërisë mjedisore me pjesëmarrje publike;
d) Përdorimi i matur dhe racional i natyrës dhe i burimeve të saj;
e) Ruajtja dhe rehabilitimi i vlerave kulturore dhe estetike të peizazhit natyror;
f) Mbrojtja dhe përmirësimi i kushteve të mjedisit;
g) Mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë së jetës dhe shëndetit të njeriut.:

Ndikime te rendesishme ne mjedis gjate zhvillimit te aktivitetit
Shkarkime ne uje
Aktiviteti zhvillohet ne brendesi te burimit ujor ne Detin Jon, ne nje distance rreth 90m nga vija bregdetare dhe ne nje thellesi deri ne 40-42m. Aktiviteti perbehet nga disa kosha lundrues te diametrave te ndryshem te cilet qendrojne te zhytur nen uje, si rrjedhoje ndikimet me te rendesishme te ketij aktiviteti jane ne ujerat detare, vecanerisht ne tabanin e detit. Ndikimet jane te rendesishme persa i perkete demtimit te cilesise se ujerave bregdetare dhe gjallesave te egra te llojeve te ndryshme qe e kane kete zone si habitatin e tyre. Rritja e peshqve ne nje densitet te tille(rritje intensive), rrit perqendrimin e disa komponenteve organik ne mjedisin ujor, vecanerisht shtresa qe depozitohet ne tabanin e detit. Kjo shkaktohet nga ndotja fekale e aktivitetit te peshqve(jashteqitje dhe urine). Elementet ndotes jane rritje te perqendrimit te ndotesve organike, por edhe njekohesisht per shkak te rritjes se perqendrimit te gjallesave ne kete pjese varferimi i ujerave nga

oksigjeni i tretur dhe ulja e intensitetit te drites ne thellesi dhe ne fundin e detit. Pervec sa me siper, aplikimi i ushqimit koncentrat, mjekimi i peshqve ne rastet e semundjeve te ndryshme, apo edhe ngordhja e tyre per shkaqe te demtimit fizik, shkaqe natyrore, asfiksimi apo nga ndonje lloj semundje e ndryshme, jane nje burim ndotje per zonen. Efekte te tilla, shkaktojne edhe frekuentimin e zones nga gjallesa te tjera te botes nenujore, nder te cilat edhe grabitqare te ndryshem.
Rastet e ngordhjes masive te peshqve, shkaktojne ndotje serioze, por keto mundesi jane te rralla, kryesisht mund te shkaktohen nga ndotja e ujit nga faktore te jashtem, nga rastet aksidentale dhe te shkarkimit te ndotesve ne mjedisin ujor, ose ne rastet e perhapjes se semundjeve te ndryshme.
Aktiviteti i mjeteve lundruese, nuk vleresohet te kete ndikime te rendesishme ne mjedisin e zones.

-Bazuar edhe ne studime te kryera ne zona te tjera per raste te ngjshme, mund te kryejme nje pershkrim te shkurter te elementeve ndotes qe shkarkohen ne mjedisin ujor dhe efektet e tyre negative:
Feçet dhe pseudo-feçet(mbetje organike nga jashteqitjet) janë grimca te ngurta me permasa nga 5 µm deri ne 5 mm që natyrshëm zhyten/dekantojnë në një shpejtësi deri në 4 mm s^{-1}.
Depozitimi i tyre në shtratin e detit të çon në pasurimin organik të sedimenteve. Në mjedisin ujor, efekti i rritjes së lëndës organike në ekosistem, nuk është me efekt pozitiv.
Zakonisht, elementi kryesor përbërës i lëndës organike është ngarkesa karbonit. Në ushqimin artificial që shëben për ushqimin e peshqve, përmbajtja mesatare e karbonit është 40 deri në 50% të peshës së thatë, përqindje nga e cila rreth 30% mbetet në feçe(mbetje organike nga jashteqitjet). Në Akuakulturë, afërsisht një kg ushqim (peshë e thatë) është i nevojshëm për të prodhuar një kg peshk. Kjo më tej shoqërohet me prodhimin e 100 deri 200 gr fece. Kështu përmbajtja e karbonit të feçes është më e lartë (nga 60 në 70%) sesa në ushqim.
Çështja e përmabjtjes organike nga këto feçe gjithashtu përmban edhe azot dhe fosfor, në shumat respektivisht 10% dhe 40% të ushqimit. Në daljet Filter, këto proporcione mund të arrijë sa më shumë si 80 dhe 90%. Në rritjen intensive të karkalecave, 63% e totalit të lëndës organike humbet. Rreth 24% e azotit dhe 84% e fosforit mbeten në sedimente, e cila është një pasojë e drejtpërdrejtë e depozitimit të feçes.
Disa nga ushqimet e tjera, komponente, të tilla si lipidet, pigmentet dhe mineralet, jane pjese e ushqimit të peshqve, çka nënkupton se mjedisi ujor, varferohet nga keto elemente gjate periudhes se rritjes intensive te peshqve. Këto molekula kanë përmbajtje të lartë të karbonit dhe kerkojne shumë oksigjen per tu oksiduar.

Produktet nxjerrës
Produktet perfundimtare te degradimit të karbohidrateve dhe lipideve shkarkohen në forme CO_2 (50% e humbjeve të karbonit) dhe H_2O. Produktet perfundimtare me prejardhje nga metabolizmi proteinave janë më komplekse, nxisin clirimin e azotit te tretshem ne uje. Tek bivalvoret, amoniaku përfaqëson 70% të azotit te shkarkuar. Ai shkon deri në 85-90% tek karkalecat dhe peshku. Amoniaku është një molekulë toksike që shkarkohet përmes qafes tek peshku dhe molusqet, dhe përmes gjëndrave (antenave) tek karkalecat.

Gjallesat ujore mund të tolerojnë një përqendrim të lartë në gjak: përqendrimet plazmatike, peshku mund të arrijnë 4 mg L^{-1}, ndërsa një koncentrim prej 0.4 mg L^{-1} është toksik tek gjitarët. Sekretimi i Amoniakut është nën kontroll i statusit ushqyes.

Varion nga 300 deri në 1500 mg N-NH4 për orë për kg të peshës trupore për karkalecat të mirë-ushqyer, nga 20 në 200 në peshq të mirë-ushqyer, por vetëm 1 mg NNH4 $kg^{-1}h^{-1}$ në ushqimet artificiale. Sekretimi i urese dhe perberjeve te tjera azotike është i ulët, përveç në disa specie atipike.
Fosfori i nxjerrje (në formë të ortofosfate) është përgjithësisht i ulët: 10 deri në 20% e futjes permes ushqimit (10 deri në 20 P-PO4 kg^{-1} d^{-1}) në peshk dhe karkaleca. Në total shkarkimin e fosforit dhe azotit nga një akuakulture llogaritet të jetë përkatësisht
10 dhe 70 kg për ton e peshkut të prodhuar. Në akuakulture klasike te karkalecave, këto shifra janë përkatësisht 25 dhe 100.
Shkarkimet ne ujera konsistojne edhe ne sasite e teperta qe dekantojne ne fund te detit nga antibiotiket e perdorur ne rastet e mjekimit te peshqve.
Dy prej antibiotikeve me te perdorur ne fushen e akuakultures ne vendet perendimore jane:

Emri	Prodhuar	Leshuar me ushqimin	Konsumim	Leshuar me fecen (I patretur)	i asimiluar ne peshk
Oxytetracycline	100	70	30	27	3
Oxolinic acid	100	70	30	18	12

Emetimet ne ajer
Emetime ne ajer nga funksionimi i ketij aktiviteti nuk ka.
Aktiviteti zhvillohet ne brendesi te ujerave detare dhe nuk ka kontakte apo shkarkime ne ajer. Ndotja e ajrit mund te vije vetem si rrjedhoje e grumbullimit dhe hedhjes se peshqve te ngordhur dhe si rrjedhoje e tyre te perhapen aroma dhe ndotje bakteriale e zones. Nje mundesi e tille eshte teper e rralle per te ndodhur por, gjithesesi nuk perjashtohet. Peshqit mund te helmohen apo te asfiksohen edhe nga faktore te jashtem si derdhja e lendeve te ndryshme ne det, te tilla si hidrokarburet dhe lubrifikantet, kjo mund te ndodhe vetem ne rastet e avarive dhe aksidentet ne mjetet lundruese qe i transportojne ato, apo ne avari te ndryshme ne portet tregtare.

Shkarkimet ne toke
Ky aktivitet nuk ka ndikime ne toke. Nuk ka ndertime te objekteve, nuk ka ndertim infrastrukture, nuk ka prodhim te mbetjeve te ngurta, apo te lengeta, etj.

Zhurmat dhe vibrimet
Emetime te zhurmave apo te vibrimeve nga funksionimi i ketij aktiviteti nuk ka. Nuk ka procese te tilla. Motobarkat e sherbimit mirembajtes jane te zakonshme si cdo mjet tjeter lundrues per distanca te shkurtra, nuk shkaktojne zhurma te larta. Aktiviteti i mjeteve lundruese, mund te sjelle largimin e faunes se eger te zones.

Mbetjet e prodhuara

Mbetje te ngurta qe prodhohen nga aktiviteti njerezor, jane mbetjet e ricikluesshme te aktivitetit te stafit, nga konsumi i perditshem ne objektet ne vijen bregdetare. Keto mbetje te ngurta si plastike, shishe qelqi, materiale letre, mbetje organike, etj transportohen ne qendrat e banuara ku depozitohen ne kontenieret e mbetjeve urbane te Njesise Vendore Bashkia Orikum.

Ndikime te tjera

Ndikimi ne mjedisin social ekonomik, nuk eshte me efekte negative, aktiviteti ndikon pozitivisht ne rritjen e punesimit, rritjen e te ardhurave te taksave vendore, te zgjerimit te bizneseve vendase dhe te prodhimit te brendshem bruto, ne rast te eksportit te peshkut apo te reduktimit te tij nga importi.

Ne afersi te kesaj zone nuk ka qendra te banuara, as infrastrukture te zhvilluar. Zona e banuar me e afert me projektin eshte qyteza e Orikumit.

Projekti nuk ndikon ne demtimin e bimesise se zones, as ne relievin apo strukturen gjeologjike te tokes. Nuk ndikohet ne rritjen apo uljen e temperaturave te ujit te detit.

5. PËRSHKRIM I SHKARKIMEVE TË MUNDSHME NË MJEDIS.

Informacion për shkarkimet në mjedis.

Ndikimet jane te rendesishme persa i perkete demtimit te cilesise se ujerave bregdetare dhe gjallesave te egra te llojeve te ndryshme qe e kane kete zone si habitatin e tyre. Rritja e peshqve ne nje densitet te tille(rritje intensive), rrit perqendrimin e disa komponenteve organik ne mjedisin ujor, vecanerisht shtresa qe depozitohet ne tabanin e detit. Kjo shkaktohet nga ndotja fekale e aktivitetit te peshqve(jashteqitje dhe urine). Elementet ndotes jane rritje te perqendrimit te ndotesve organike, por edhe njekohesisht per shkak te rritjes se perqendrimit te gjallesave ne kete pjese varferimi i ujerave nga oksigjeni i tretur dhe ulja e intensitetit te drites ne thellesi dhe ne fundin e detit. Pervec sa me siper, aplikimi i ushqimit koncentrat, mjekimi i peshqve ne rastet e semundjeve te ndryshme, apo edhe ngordhja e tyre per shkaqe te demtimit fizik, shkaqe natyrore, asfiksimi apo nga ndonje lloj semundje e ndryshme, jane nje burim ndotje per zonen. Efekte te tilla, shkaktojne edhe frekuentimin e zones nga gjallesa te tjera te botes nenujore, nder te cilat edhe grabitqare te ndryshem.

-Bazuar edhe ne studime te kryera ne zona te tjera per raste te ngjshme, mund te kryejme nje pershkrim te shkurter te elementeve ndotes qe shkarkohen ne mjedisin ujor dhe efektet e tyre negative:

Feçet dhe pseudo-feçet(mbetje organike nga jashteqitjet) janë grimca te ngurta me permasa nga 5 µm deri ne 5 mm që natyrshëm zhyten/dekantojnë në një shpejtësi deri në 4 mm s^{-1}. Depozitimi i tyre në shtratin e detit të çon në pasurimin organik të sedimenteve. Në mjedisin ujor, efekti i rritjes së lëndës organike në ekosistem, nuk është me efekt pozitiv.

Zakonisht, elementi kryesor përbërës i lëndës organike është ngarkesa karbonit. Në ushqimin artificial që shëben për ushqimin e peshqve, përmbajtja mesatare e karbonit është 40 deri në 50% të peshës së thatë, përqindje nga e cila rreth 30% mbetet në feçe(mbetje organike nga jashteqitjet). Në Akuakulturë, afërsisht një kg ushqim (peshë e thatë) është i nevojshëm për të prodhuar një kg peshk. Kjo më tej shoqërohet me prodhimin e 100 deri 200 gr fece. Kështu përmbajtja e karbonit të feçes është më e lartë (nga 60 në 70%) sesa në ushqim.

Çështja e përmabjtjes organike nga këto feçe gjithashtu përmban edhe azot dhe fosfor, në shumat respektivisht 10% dhe 40% të ushqimit. Në daljet Filter, këto proporcione mund të arrijë sa më shumë si 80 dhe 90%. Në rritjen intensive të karkalecave, 63% e totalit të lëndës organike humbet. Rreth 24% e azotit dhe 84% e fosforit mbeten në sedimente, e cila është një pasojë e drejtpërdrejtë e depozitimit të feçes.
Disa nga ushqimet e tjera, komponente, të tilla si lipidet, pigmentet dhe mineralet, jane pjese e ushqimit të peshqve, çka nënkupton se mjedisi ujor, varferohet nga keto elemente gjate periudhes se rritjes intensive te peshqve. Këto molekula kanë përmbajtje të lartë të karbonit dhe kerkojne shumë oksigjen per tu oksiduar.
Produktet perfundimtare te degradimit të karbohidrateve dhe lipideve shkarkohen në forme CO_2 (50% e humbjeve të karbonit) dhe H_2O. Produktet perfundimtare me prejardhje nga metabolizmi proteinave janë më komplekse, nxisin clirimin e azotit te tretshem ne uje. Tek bivalvoret, amoniaku përfaqëson 70% të azotit te shkarkuar. Ai shkon deri në 85-90% tek karkalecat dhe peshku. Amoniaku është një molekulë toksike që shkarkohet përmes qafes tek peshku dhe molusqet, dhe përmes gjëndrave (antenave) tek karkalecat.
Gjallesat ujore mund të tolerojnë një përqendrim të lartë në gjak: përqendrimet plazmatike, peshku mund të arrijnë 4 mg L^{-1}, ndërsa një koncentrim prej 0.4 mg L^{-1} është toksik tek gjitarët. Sekretimi i Amoniakut është nën kontroll i statusit ushqyes.
Varion nga 300 deri në 1500 mg N-NH4 për orë për kg të peshës trupore për karkalecat të mirë-ushqyer, nga 20 në 200 në peshq të mirë-ushqyer, por vetëm 1 mg NNH4 $kg^{-1}h^{-1}$ në ushqimet artificiale. Sekretimi i urese dhe perberjeve te tjera azotike është i ulët, përveç në disa specie atipike.
Fosfori i nxjerrje (në formë të ortofosfate) është përgjithësisht i ulët: 10 deri në 20% e futjes permes ushqimit (10 deri në 20 P-PO4 kg^{-1} d^{-1}) në peshk dhe karkaleca. Në total shkarkimin e fosforit dhe azotit nga një akuakulture llogaritet të jetë përkatësisht
10 dhe 70 kg për ton e peshkut të prodhuar. Në akuakulture klasike te karkalecave, këto shifra janë përkatësisht 25 dhe 100.
Shkarkimet ne ujera konsistojne edhe ne sasite e teperta qe dekantojne ne fund te detit nga antibiotiket e perdorur ne rastet e mjekimit te peshqve.
Subjekti gjate zhvillimit te aktivitetit duhet qe te kryeje monitorime dhe vezhgime periodike te cilesise se ujerave bregdetare, duke matur dhe analizuar nepermjet laboratoreve te akredituar nivelin e NBO, NKO dhe O_2.

6. INFORMACIONI PËR KOHËZGJATJEN E MUNDSHME TË NDIKIMEVE NEGATIVE.

Ndikimi ne mjedis do te jete ne mjedisin ujor te zones. Ky ndikim do te jete i perhershem per aq kohe sa do te kete kultivim te peshqve. Ky ndikim pjeserisht mund te jete me veti akumuluese ne mjedis. Nga aktiviteti i rritjes se peshkut, mund te shkarkohen elemente te demshem per mjedisin ujor te tilla si: CO_2, N-NH_4, PO_4, . Keto shkarkime vijne nga aktiviteti jetesor i peshqve, nga mbetjet organike te ushqimeve, nga jashteqitjet kur peshqit jane ne sasi dhe ne numer te madh brenda nje siperfaqeje, nga aplikimi/perdorimi i medikamenteve per kurimin e tyre nga semundjet e ndryshme, nga ngordhja e tyre nga shkaqe natyrore, fizike ose te semundjeve te ndryshme, ndikojne ne pakesimin ose varferimin e ujit me oksigjen, uljen e intensitetit te drites ne thelesine e detit, etj.

7. SHTRIRJA HAPËSINORE E NDIKIMIT NEGATIV NË MJEDISIN E ZONËS

Ndikimi ne mjedisin ujor te zones ka efektet e tij ne nje distance jo shume te larget, por gjithesesi te konsiderueshme. Ky ndikim eshte i perhershem per aq kohe sa do te kete kultivim te peshqve. Ky ndikim pjeserisht mund te jete me veti akumuluese ne mjedis. Nga aktiviteti i rritjes se peshkut, mund te shkarkohen elemente te demshem per mjedisin ujor.

8. REHABILITIMI I MJEDISIT TË NDIKUAR DHE MUNDËSIA E KTHIMIT TË TIJ NË GJENDJEN E MËPARSHME.

Nga ky aktivitet, shkakton ndotje te mjedisit ujor dhe si rrjedhoje edhe demtim te ekosistemit te kesaj zone shfrytezimi. Ndikimi i mjedisit do te zgjase per aq kohe sa do te kete kultivim te nje apo dy llojeve te peshqve. Ndikimi ne rast te mbylljes se aktivitetit, mund te zgjase deri ne disa muaj me pas, por ky ndikim nuk mund te rehabilitohet apo te nderhyet nga punimet e individeve te ndryshem, per rekuperimin e saj, zona kerkon kohen dhe proceset natyrore te nevojshme per te kryer nje rehabilitim te vetevetes. Mundesia e kthimit te mjedisit ne gjendjen e tij te mepareshme do te ishte eficiente vetem ne rast se lejohet qe vete natyra te kryeje rehabilitimin e zones. Per te ruajtur nje mjedis cilesisht te pranueshem, duhet qe densiteti i rritjes se peshqve te mos kaloje normat e lejuara.

9. MASAT E MUNDSHME PËR SHMANGIEN DHE ZBUTJEN E NDIKIMEVE NEGATIVE NË MJEDIS.

Ne menyre te pergjithshme do te japim disa prej masave qe do te zbatohen nga subjekti per zhvillimin e aktivitetit. Disa prej masave kryesore qe do te ndermerren jane permendur ne menyre te permbledhur si me poshte:

- Kultivimi i peshqve brenda normes se lejuar te dendesise per m^3, per te shmangur demtimet e tyre dhe si rrjedhoje edhe ngordhjen.
- Respektimi i dendesise se lejuar te kultivimit te peshkut, ndikon edhe ne ruajtjen e mjedisit ujor, pasi perqendrimi i larte i lendes organike ne tabanin e detit, ndikon negativisht ne shkaterrimin e ekosistemit nenujor.(lenda organike permban sasi te larte te dioksidit te karbonit, Azot, si dhe Fosfor.
- Ushqimi i tyre te jete i kontrolluar dhe i çertifikuar per lendet e demshme qe mund te kete ne permbajtje.
- Rrasati i peshkut te sigurohet nga ambjente te posacme.
- Perdorimi i mjekimeve te kryhet nen mbikqyrjen e rrepte te veterinerit.
- Te menaxhohen ne menyre te integruar mbetjet e peshqve te ngordhur.
- Te mos hidhen ne asnje menyre mbetje organike apo te ngurta urbane ne mjedisin ujor dhe ate tokesor te zones bregdetare.
- Te sigurohet ambjenti i vaskave dhe te ruhet nga demtimet dhe ndotjet e faktoreve te jashtem

- Te perdoren mjete lundruese te reja dhe te kolauduara.
- Te reduktohet impakti i ndertimeve te objekteve duke perdorur ngjyra te posacme dhe mbjellje pemesh.
- Te mos ndertohen objekte magazina frigoriferike etj ne vijen bregdetare ku ndodhet aktiviteti, ato te funksionojne ne qendrat e banuara.
- Te mos demtohet mjedisi i zones dhe vlerat turistike te saj.
- Ujerat e zeza te vend-rojeve te menaxhohen me grope septike dhe te mos derdhen ne mjedisin ujor te zones.

10. NDIKIMET E MUNDSHME NË MJEDISIN NDËRKUFITAR (NQS KA).

Ky projekt nuk ndodhet prane kufirit shteteror. Duke qene ne nje distance te larget nga kufiri shteteror i ujerave nder-territoriale, ky aktivitet nuk vleresohet te preke zonat kufitare dhe si rrjedhoje edhe ndikimi i tij nuk shkakton demtim te mjedisit nderkufitar. Projekti nuk ndikon ne cenimin e sigurise se jetes dhe shendetit te shteteve fqinje, as te qendrave te banuara te rajonit. Nuk vleresohet te ndikohen burimet ujore nderkufitare, nuk ndikohet cilesia e ajrit ne kontekstin nderkufitar. Per kete kapitull, nuk kryhen vleresime dhe analiza te detajuara per shkak te vendodhjes se projektit ne brendesi te kufirit shteteror dhe distances qe ai ruan me kufirin dhe shtetet fqinje.

ANEKS 1: Vendodhja

Gjiri Rraguza 2, Karaburun, Bashkia Orikum, Qarku Vlore.

Harta topografike (Nomeklatura e hartes 1:10,000 K-34-123-D-d-3)



Koordinatat në sistemin Universal ETRS89		
	Koordinatat Veri	Koordinatat Lindje
Pika Nr. 1	**40°21`26.24"**	**19°24`25.50"**
Pika Nr. 2	**40°21`20.05"**	**19°24`27.05"**
Pika Nr. 3	**40°21`20.89"**	**19°24`36.06"**
Pika Nr. 4	**40°21`27.34"**	**19°24`31.74"**
Siperfaqja ujore= 5ha , Thellesia 40-42m		

Koordinatat në sistemin Gaus-Kruger		
	Koordinatat Y	Koordinatat X
Pika Nr. 1	**43 64 790.00**	**44 70 607.00**
Pika Nr. 2	**43 64 925.00**	**44 70 595.00**
Pika Nr. 3	**43 65 105.00**	**44 70 547.00**
Pika Nr. 4	**43 65 140.00**	**44 70 396.00**
Pika Nr. 5	**43 64 829.00**	**44 70 404.00**
Siperfaqja ujore= 5ha , Thellesia 40-42m		

Sqarim: Siperfaqja ne te dyja sistemet koordinative eshte e njejte, nuk ka ndryshim siperfaqeje, por per efekt te kontrates ekzistuese e cila i ka te shprehura koordinatat ne sistemin ETRS89, i paraqesim ne te njejtin sistem. Nderkohe qe koordinatat Gaus-Kruger jane po per te njejten siperfaqe, por pika 2 eshte thjesht nje saktesim i nje kufiri jo te drejte, por vije e lakuar sic shihet edhe ne harten e meposhteme.

PARAQITJE GRAFIKE E SIPERFAQES UJORE
NE SHFRYTEZIM TE **FIRMES "VANGJELI 2002" SH.P.K**
SIPERFAQJA UJORE NDODHET NE VENDIN RAGUZA-2
- SIPERFAQE UJORE = 5 Ha

SH.1:25000



KORDINATAT E KULMEVE

PIKA	X	Y
1	4 470 607.0	4 364 [illegible]
2	4 470 595.0	4 364 925.[illegible]
3	4 470 547.0	4 365 105.[illegible]
4	[illegible]	[illegible]

ANEKS : Pamje satelitore

Pamje satelitore te zones ku zhvillohet aktiviteti